

AKT - THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE

"C.E.P.A" SH.P.K

Sot, më datë 06.02.2023 (dymijë e njëzet e tre), Ne të nënshkruarit:

Arben KORA, i biri i Stavri dhe Lirie, i datëlindjes 22.03.1971, lindur dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. Personal H10322175P madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

Leonard SEJDINI, i biri i Hidër dhe Qamile, i datëlindjes 31.08.1977, lindur dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. Personal H70831096F madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar,

Bazuar ne Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" *vendosëm* të themelojmë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "C.E.P.A" SHPK, sipas parashikimeve të mëposhtme:

NENI 1

Emri i shoqërisë

Emërtimi i Plotë i Shoqërisë Tregtare është "C.E.P.A" SH.P.K.

NENI 2

Selia e shoqërisë

Shoqëria do të ketë selinë e saj në Tiranë në adresën Njesia Administrative Kashar, Rruga 28 Nentori, Nr.82, Yrshek, Tiranë


NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

Importim/Tregtim pjese kembimi (te reja dhe te perdorura) per automjete, gjeneratore, makineri ne fushen e industrise se ndertimit e tjere. Pjesemarres si ndermjetes ne tregtimin e makinave te reja dhe te perdorura ne fushen e industrise se ndertimit. Mirembajtja dhe riparim automjete.

Shoqëria kryen cdo lloj aktiviteti që ben pjese ne objektin e saj, qe lidhet me te dhe qe e mbeshtet ate.



1



Shoqëria mund të kryejë dhe cdo veprimtari tjetër e cila është në ndihmë dhe e lidhur me objektin kryesor të veprimtarisë së saj.

NENI 4 Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributet e ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në të holla me vlerën 200,000 (dyqind mijë) LEKË. Kapitali themeltar ndahet në 2 kuota, ku secila prej tyre ka vlerë nominale prej 100,000 (njëqind mijë) LEKË. Ortaku themelues Arben Kora do të zotërojë 1 kuotë të barabartë me 50 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë dhe ortakë themelues Leonard Sejдини do të zotërojë 1 kuotë të barabartë me 50 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Kapitali themeltar do të shlyhet nga ortakët themelues në llogarinet bankare të Shoqërisë, pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Një kopje e mandat pagesave bankare të shlyerjes së kapitalit themeltar nga ana e Ortakëve të Shoqërisë, depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit si deklarim vullnetar nga Administratori i Shoqërisë.

NENI 5 Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktivitetit fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 6 Organet Drejtuese

Në zbatim të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të Shoqërisë janë si më poshtë vijon :

1. Asambleja e Përgjithshme – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë;

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të këtyre organeve rregullohet dhe ushtrohet sipas parashikimeve të Statutit të Shoqërisë dhe legjislacionit në fuqi.

Shoqëria do të perfaqësohet ligjërisht nga Administratori i saj i cili është Leonard SEJDINI i biri i Hidër dhe Qamile, i datëlindjes 31.08.1977, lindur dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. Personal H70831096F.


NENI 7
Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje të njëjta në gjuhën shqipe.
Me nënshkrimin e këtij Akt Themelimi, ortakët themelues detyrohen që të hartojnë dhe nënshkruajë Statutin e Shoqërise, një kopje e të cilit do të depozitohet në QKB.

Ngarkohet Administratori i Shoqërise që të kryejë procedurat e Rregjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombetare të Biznesit. Këtë detyrim, Administratori mund ta kryejë personalisht, ose përmes personave të caktuar prej tij me Autorizim ose Prokurë të Posaçme.

Ortakët Themelues

LEONARD SEJDINI

Leonard Sejdini


ARBEN KORA

Arben Kora
Ben